



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 30

Tiranë – E premte, 6 mars 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 201, datë 5.3.2020	Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurës për përzgjedhjen e këshilltarit financiar për menaxhimin e borxhit shtetëror.....	2721
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 5.3.2020	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale.....	2722



VENDIM
Nr. 201, datë 5.3.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE
TË PROCEDURËS PËR PËRZGJEDHJEN
E KËSHILLTARIT FINANCIAR PËR
MENAXHIMIN E BORXHIT
SHTETËROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të parë, të nenit 31, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e procedurës që do të ndiqet për procesin e përzgjedhjes së këshilltarit financiar për menaxhimin e borxhit shtetëror, duke mbajtur në konsideratë ndjeshmërinë e tregjeve financiare nga faktorë të brendshëm e të jashtëm, me qëllim sigurimin e fondeve të nevojshme të huamarrjes, duke vlerësuar riskun dhe koston e tij, në këndvështrimin afatmesëm e afatgjatë, si dhe zhvillimin e tregut të titujve të shtetit, nëpërmjet shtimit të instrumenteve të tij dhe zgjerimit të bazës së investitorëve.

2. Bazuar në nevojën për asistencë, sipas pikës 1 të këtij vendimi, në ligjin vjetor të buxhetit dhe në Strategjinë e Menaxhimit të Borxhit Publik, me propozimin e strukturës përgjegjëse për borxhin publik, në bashkëpunim me struktura të tjera të ministrisë përgjegjëse për financat, ministri përgjegjës për financat miraton kërkesën për propozim për përzgjedhjen e këshilltarit financiar për menaxhimin e borxhit shtetëror dhe publikimin e saj.

3. Në kërkesën për propozim duhet të përcaktohen:

- a) qëllimi i emërimit të këshilltarit financiar;
- b) shërbimi, që kërkohet të merret nga këshilltari financiar;
- c) kriteret e përzgjedhjes;
- d) afati i paraqitjes së propozimeve;
- e) data, ora dhe vendi i paraqitjes së propozimeve;
- dh) çdo element tjetër i vlerësuar si i nevojshëm.

4. Ministria përgjegjëse për financat publikon ftesën për ofertë në faqen e saj zyrtare të internetit.

5. Në rast se përpara përfundimit të afatit të dorëzimit të propozimeve ofertuesit e interesuar kërkojnë shtyrjen e këtij afati, titullari i institucionit, pas shqyrtimit të kërkesës, vendos pranimin ose refuzimin e saj. Vendimi për shtyrjen e afatit publikohet në faqen zyrtare të internetit të ministrisë përgjegjëse për financat.

6. Pas dorëzimit zyrtar të propozimeve nga ofertuesit e interesuar në protokollin e ministrisë përgjegjëse për financat, struktura përgjegjëse për borxhin publik në ministri, në bashkëpunim me struktura të tjera të kësaj ministrie, fillon vlerësimin e tyre. Afati për kryerjen e vlerësimeve është 10 (dhjetë) ditë pune, nga data e përfundimit të afatit për dorëzimin e propozimeve. Në varësi të analizave paraprake të propozimeve, në rast se struktura përgjegjëse për borxhin publik e gjykon të arsyeshme, mund t’u kërkojë ofertuesve propozues të dërgojnë sqarime dhe informacion shtesë, duke u caktuar edhe afatin e paraqitjes së tyre. Në këtë rast, afati i vlerësimit shtyhet me 5 (pesë) ditë pune, nga data e paraqitjes së sqarimeve shtesë.

7. Vlerësimi i propozimeve kryhet nga struktura përgjegjëse për borxhin publik, në bashkëpunim me struktura të tjera të ministrisë përgjegjëse për financat, duke u bazuar në:

- a) eksperiencën e ofertuesit në dhënien e shërbimeve të ngjashme;
- b) kapacitetin për ofrimin e shërbimit të kërkuar;
- c) oferta ekonomike.

8. Struktura përgjegjëse për borxhin publik, në bashkëpunim me struktura të tjera të ministrisë përgjegjëse për financat në ministri, përgatit një raport përmbledhës, ku renditen ofertuesit pjesëmarrës në procedurë, të cilin ia dërgon për miratim ministrit.

9. Ministri, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga paraqitja e raportit përmbledhës nga struktura përgjegjëse për borxhin publik, vendos të miratojë ose të refuzojë shpalljen e fituesit për këshilltar financiar për menaxhimin e borxhit shtetëror apo të përsëritë procedurën.

10. Shpallja e fituesit publikohet në faqen zyrtare të internetit të ministrisë përgjegjëse për financat.

11. Ankesat e subjekteve ndaj procedurës së zhvilluar i paraqiten ministrit, brenda 5 (pesë)



ditëve pune, nga data e njoftimit, i cili merr vendim brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e paraqitjes së ankesës.

12. Ministri, pas përfundimit të afatit të ankimit, negocion dhe nënshkruan marrëveshjen me ofertuesin fitues, e cila përmban, ndërmjet të tjerash, termat kryesorë të ofrimit të shërbimit.

13. Efektet financiare për vitin 2020 do të mbulohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

14. Ngarkohet ministria përgjegjëse për financat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 202, datë 5.3.2020

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË
BUXHETIN E VITIT 2020, PËR
FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË
BANESAVE INDIVIDUALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjes “i”, të shkronjës “b”, të nenit 13, dhe të nenit 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, në masën 8 736 419 145 (tetë miliardë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë milionë e katërqind e nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e pesë) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, sipas projekteve model të miratuara.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1 t’u kalojë njësisë zbatuese, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm” të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 6 528 564 252 (gjashtë miliardë e pesëqind e njëzet e tetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e dy) lekësh.

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi prej 2 207 854 893 (dy miliardë e dyqind e shtatë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e katër mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre) lekësh, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave të prokurimit në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin “Fondi për rindërtim” të buxhetit të shtetit.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 56 lekë